



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: 03-03/DPK
Broj stanica: 02

Nr Prot: 01-2054/16
Bi Prot: 01-2054/16
Data: 15-06-2016

PRISHTINE

DATË/A:	14/06/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/1959/16
PËR/ZA/TO:	z. Haxhi BEJTA Menaxher i Prokurimit - Komuna Skenderaj
CC:	z. Fadil NURA Nënkyetar – Komuna Skenderaj
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: Asfaltimi i rrugës në fshatinë Likovc L=4760m'

I nderuar z. BEJTA,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nën par. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nën par. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nën par. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Asfaltimi i rrugës në fshatin Likovc L=4760m” me numër prokurimi: 643/16/013/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Asfaltimi i rrugës në fshatin Likovc L=4760m” me numër prokurimi: 643/16/013/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna Skenderaj keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugës në fshatin Likovc L=4760m" me numër prokurimi: 643/16/013/121, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 02/06/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për punë.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në kritere që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Njoftim për Kontratë, tek pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: Evidenca 4 - Një listë e projekteve të realizuara për tri (3) vitet e fundit jo me pak se 540,000.00 € duke saktësuar punët e ofruara, shumën e kontratës, datën dhe pranimin e punëve. Ndërsa vlera e parashikuar e kontratës është 270,000.00 €. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrajnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në rastin e juaj keni kaluar mbi 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në Dosjen e Tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 keni kërkuar: c) Lista e referencave të natyrës së njëjtë (Ndërtimi i trotuareve ose rrugëve, deri sa "Dëshmia e kërkuar dokumentare" nuk është kërkuar asgjë. Kurdo që një aktivitet i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të kompletohet para publikimit të njoftimit të kontratës dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. Referuar në legjislacionin aktual për prokurim publik, përcaktimi kritereve të tilla mund të favorizon operatorët e caktuar ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminon të tjerët.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare si dhe të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !